



Pml.nr.692/2023

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Agim Maliqi kryetar i kolegjit, Rasim Rasimi dhe Valdete Daka, anëtare, me bashkëpunëtorin profesionale Mirlinda Mejzini-Simnica, procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të dënuarit A. H., për shkak të veprës penale keqpërdorimi i besimit, nga neni 342, paragrafi 2. të KPRK-së, duke vendosur, sipas kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë e paraqitur nga mbrojtësi i të dënuarit, kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, P.nr.4986/16 të datës 25.04.2023 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, PA1.nr.822/23 të datës 25.09.2023, në seancën e kolegjit, të mbajtur më datë 25.01.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Me miratimin e kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtësit të të dënuarit A. H., ndryshohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, P.nr.4986/16 të datës 25.04.2023 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, PA1.nr.822/23 të datës 25.09.2023, në atë mënyrë që rikualifikohet vepra penale dhe konstatohet se në veprimet e të dënuarit janë realizuar elementet e veprës penale keqpërdorimi i besimit, nga neni 342, paragrafi 1. të KPRK-së, ashtu që kundër të dënuarit, konform nenit 362, paragrafi 1.3 të KPP-së,

Refuzohet akuza

Se me datë 31.07.2014, në Prishtinë, në cilësinë e personit të autorizuar nga tani i dëmtuari I. M., me autorizimin Ref.LRO.nr....., të datës 17.05.2014, me qëllim që vetes apo personit tjetër t'i sjell dobi pasurore në mënyrë të kundërligjshme, ka keqpërdorur autorizimet e tij, ashtu që banesën e cila gjendet në lagjen "...", në P., ia ka shitur blerëses B. K. në vlerë prej 53,000.00 Euro, sipas autorizimit, por të njëjtën e ka udhëzuar që shumën e parave në vlerë prej 44,734.00 Euro ta paguaj në llogarinë bankare të të dëmtuarit, ndërsa shumën e parave në vlerë prej 8,266.00 Euro, ta paguaj në llogarinë e të dënuarit, me ç'rast të dëmtuarit i ka shkaktuar dëm material në vlerë prej 7,266.00 Euro,

- me çka kishte për të kryer veprën penale keqpërdorimi i besimit, nga neni 342, paragrafi 1. të KPRK-së, për shkak të parashkrimit absolut të ndjekjes penale.

Shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore të gjykatës.

I dëmtuari për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë –Departamenti i Përgjithshëm, me aktgjykimin P.nr.4986/16 të datës 25.04.2023, të dënuarin A. H., e ka shpallur fajtor për veprën penale keqpërdorimi i besimit, nga neni 342, paragrafi 2. të KPRK-së dhe i ka shqiptuar dënim me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve, i cili dënim me pëlqimin e të dënuarit, konform nenit 47 të KPRK-së, zëvendësohet me dënim me gjobë, në shumën prej 3,500 (tremijepesëqind) Euro, dënim të cilin është i obliguar ta paguaj në afat prej 30 ditëve nga kur ky aktgjykim të bëhet i plotfuqishëm. I dënuari është obliguar që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 (njëzet) Euro, si dhe shumën prej 20 (njëzet) Euro në emër të kompensimit të viktimave të krimit, si dhe të kompensoj palën e dëmtuar I. M. në shumë prej 7,266 (shtatë mijë e dyqind e gjashtëdhjetegjashtë) Euro.

Gjykata e Apelit e Kosovës, me aktgjykimin PA1.nr.822/23 të datës 25.09.2023, e ka refuzuar ankesën e mbrojtësit të dënuarit, ndërsa e ka vërtetuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë.

Kundër këtyre aktgjykimeve, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë, ka paraqitur mbrojtësi i të dënuarit A. H., avokati Gëzim Berisha nga P., për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 432, paragrafi 1., pikat 1.1. dhe 1.3. të KPP-së dhe për shkak të shkeljes së ligjit penal nga neni 385, paragrafi 1., pikat 1.3. dhe 1.4. të KPP-së, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës, ta aprovoj si të bazuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë dhe të anuloj aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë dhe atë të gjykatës së shkallës së dytë.

Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit e Kosovës, me shkresën KMLP.II.nr.408/23 e datës 27.12.2023, ka propozuar që kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë të refuzohet si e pabazuar.

Në kërkesë, mbrojtësi i të dënuarit thekson se të dy gjykatat nuk kanë arritur t'i analizojnë bazën juridike apo kualifikimin ligjor të veprës penale, që është dallim substancial me tyre e që ka të bëjë me statusin e kryerësit të veprës penale, formë e cilësuar e kësaj vepre penale keqpërdorimi i besimit, nga neni 342, paragrafi 2. të KPRK-së është statusi i kryerësit të veprës penale, ndërsa i dënuari as nuk ka qenë kujdestar e as avokat i pasurisë së dëmtuarit, andaj me asnjë provë të vetme nuk është vërtetuar se i dënuari të ketë kryer veprën penale sipas paragrafit 2. të këtij neni.

Më tutje pretendohet se sipas gjendjes faktike që është vërtetuar nga të dy instancat gjyqësore, ndjekja penale dhe vepra penale është parashkruar dhe gjykatat ka qenë dashur që ta refuzojnë aktakuzën PP.II.nr.7614 të datës 25.11.2016, për shkak të parashkrimit absolut.

Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit shqyrtoi shkresat e lëndës në kuptim të nenit 435, paragrafi 1., lidhur me nenin 436, paragrafi 1. të KPP-së dhe pas vlerësimit të pretendimeve në kërkesë, gjeti se:

-kërkesa është e bazuar.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, pretendimet e mbrojtësit të të dënuarit, janë të bazuara, ngase aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë dhe i gjykatës së shkallës së dytë janë marrë në shkelje të ligjit penal nga neni 385, paragrafi 1., nën-paragrafi 1.3. të KPP-së, pasi që në rastin konkret aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë ishte marrë pas kalimit të afatit të parashkrimit absolut të ndjekjes penale.

Përshkrimi i dispozitivit të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë del se është në kundërshtim me kualifikimin ligjor të veprës penale, meqë në dispozitiv është cekur se *“...në cilësinë e personit të autorizuar nga tani i dëmtuari I. M., me autorizimin Ref.LRO.nr....., të datës 17.05.2014...”*, kurse kualifikimi ligjor ishte bërë sipas dispozitës së nenit 342, paragrafi 2. të KPRK-së, sipas të cilit *“nëse vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni kryhet nga kujdestari, avokati apo ndonjë person tjetër që ka detyrim ligjor ndaj pronarit të pasurisë...”*.

Gjykata Supreme e Kosovës bazuar në dispozitën e nenit 359, paragrafi 2. të KPP-së, vlerëson se *“...gjykata nuk detyrohet me propozimin e prokurorit të shtetit lidhur me kualifikimin ligjor të veprës penale”*, ashtu që bazuar në përshkrimin e dispozitivit të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, vlerësoi se në veprimet e të dënuarit janë prezentë të gjitha elementet e figurës së veprës penale keqpërdorimi i besimit, nga neni 342, paragrafi 1. të KPRK-së, sepse në rastin konkret i dënuari ka qenë person i autorizuar, sipas autorizimit Ref.LRO.nr....., të datës 17.05.2014, ashtu siç është paraparë në paragrafin 1. të nenit 342 të KPRK-së, mirëpo nuk ka pasur cilësi të veçantë siç kërkohet me dispozitën 342, paragrafi 2. të KPRK-së, andaj bëri rikualifikimin e veprës penale siç është përshkruar në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Gjykata Supreme e Kosovës me rastin e rikualifikimit të veprës penale, pati për bazë përshkrimin e dispozitivit të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, me ç'rast konstatoi se vepra penale ishte kryer me datë 31.07.2014, kurse për këtë vepër penale parashihet dënim me burgim deri në 3 (tre) vjet. Bazuar në dispozitën e nenit 106, paragrafi 1., nën-paragrafi 1.5. të KPRK-së, parashihet se ndjekja penale nuk mund të ndërmerret në rastet kur ka kaluar afati prej 3 (tre) vite nga kryerja e veprës penale të dënueshme me më shumë se 1 (një) vit burgim, kurse sipas dispozitës së nenit 107, paragrafi 8. të KPRK-së, ndjekja penale ndalohet në çdo rast kur të ketë kaluar dyfishi i kohës së afatit të parashkrimit.

Pasi që për veprën penale keqpërdorimi i besimit, nga neni 342, paragrafi 1. të KPRK-së, parashihet dënim me burgim deri në 3 (tri) vite, rrjedhimisht në rastin konkret rezulton se gjykata e shkallës së parë aktgjykimin e saj e ka marrë me datë 25.04.2023, që nënkupton se kishin kaluar mbi 9 (nëntë) vite nga koha e kryerjes së kësaj vepre penale, përkatësisht pasi që kishte kaluar afati i parashkrimit absolut të ndjekjes penale.

Nga këto arsye, kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë ishte e bazuar dhe konform nenit 438, paragrafi 1., nën-paragrafi 1.1. të KPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - PRISHTINË

Pml.nr.692/2023, më 25.01.2024

Bashkëpunëtorja profesionale,
Mirlinda Mejzini-Simnica

Kryetar i kolegjit,
Agim Maliqi